

## **Qeveria shfuqizon vendimin që ia dhuronte UNESCO-s, “Ngjallja e L Lazarit” qëndron në Shqipëri**



Këshilli i Ministrave shfuqizoi sot vendimin “Për dhurimin UNESCO-s të ikonës “Ngjallja e L Lazarit”, në kuadër të 60-vjetorit të anëtarësimit të Shqipërisë në këtë organizatë”.

Vendimi i sotëm shfuqizoi vendimin e mëparshëm me nr. 564, datë 29.9.2018, sipas së cilit ikona do t'i dhurohej UNESCO-s, në kuadër të 60-vjetorit të anëtarësimit të Shqipërisë në këtë organizatë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, ndërsa për zbatimin e tij ngarkohet Ministria e Kulturës.

Ikona “Ngjallja e L Lazarit” u restaurua në mars 2018. E realizuar në fillimet e shekullit XIX ajo është vlerësuar nga specialistët si një vepër me nivel të lartë artistik.

